

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

Rezultatet e masave në Shqipëri në kuadrin e Instrumentit Horizontal të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

ÇFARË ËSHTË INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË?

Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë është një nismë bashkëpunimi e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Evropën Juglindore. Ky është një program tre-vjeçar, i cili po zbatohet që nga muaji maj 2016 për një periudhë prej 36 muajsh. Masat në kuadrin e Instrumentit Horizontal financohen kryesisht nga BE-ja dhe bashkëfinancohen dhe zbatohen nga Këshilli i Evropës.

Përmes Instrumentit Horizontal, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës ndihmojnë vendet përfituese në Evropën Juglindore në përmbushjen e standardeve të Këshillit të Evropës dhe *acquis* të Bashkimit Evropian në kuadër të procesit të zgjerimit, duke mbuluar tri tema: *sigurimin e drejtësisë, luftën kundër kimit ekonomik, dhe luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cenueshme*.

Në këtë kuadër, Shqipëria përfiton prej shtatë projektsh specifike me një buxhet të përgjithshëm prej 4.75 milion Eurosh.

RRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMIT NË BURGJE

Ky projekt është zbatuar nga 1 tetori 2016 deri më 30 shtator 2018.

Ky projekt kishte për qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor në burgje, pas mangësive të identifikuar në këto fusha nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT) dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Kushtet e këqija në burgje jo vetëm që e pengojnë ri-integrimin e të burgosurve në shoqëri, por mund edhe të çojnë në shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

- Ky projekt ndihmoi në përforcimin e një qasjeje rehabilituese në vend të asaj ndëshkuese ndaj të burgosurve në vend, duke u ofruar autoriteteve të burgjeve instrumente të ndryshme legjislative dhe praktike. Përveç kësaj, u hartuan rregullore të brendshme të burgjeve dhe u rishikua Ligji për Trajtimin e të Burgosurve. Theksi iu vu qasjes individuale, e cila përfshin vlerësimin e risqeve që çdo i burgosur paraqet ndaj shoqërisë. Për vënien në zbatim të kësaj qasjeje në praktikë, projekti ofroi një instrument për vlerësimin e risqeve dhe nevojave dhe në kuadrin e tij u trajnuan më shumë se 100 punonjës burgjesh lidhur me përdorimin praktik të tij. Si rrjedhojë, punonjësit e burgjeve përftuan aftësi në përdorimin e këtij instrumenti gjatë intervistimeve, duke i bërë ata të aftë për të përgatitur plane individuale për të burgosurit bazuar në nevojat dhe rrethanat e tyre.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



- U përmirësuan shërbimet e kujdesit shëndetësor në burgje për të ulur rreziqet që të burgosurit mund t'i paraqesin shoqërisë pas lirimit të tyre për shkak të kujdesit të pamjaftueshëm shëndetësor gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në burg. U realizua një vlerësim i shërbimeve shëndetësore në burgje, i cili prodhoi një pasqyrë të përgjithshme të nevojave dhe fushave që kanë nevojë për përmirësim në kujdesin e ofruar në burgje. Për të adresuar mangësitë e identifikuara, u hartua një “Manual për Parandalimin e Vetëvrasjes në Burgje” dhe punonjësit u trajnuan për të ofruar kujdes dhe trajtim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për të burgosurit. Përveç kësaj, Ministrisë së Drejtësisë iu dhanë disa rekomandime për masat e propozuara për krijimin e një institucioni të ri mjeko-ligjor dhe për transformimin e burgut të Lezhës në spital për pacientët me raport mjeko-ligjor.
- Në kuadrin e këtij projekti u zhvilluan disa instrumente për të adresuar më mirë sjelljet joetike dhe të papërshtatshme nga punonjësit e burgjeve. Sjellje të tilladëmtojnë besimin e publikut tek shërbimi penitenciar dhe për këtë arsye duhet të çrrënjosen. Kodi i Rishikuar i Etikës për punonjësit e burgjeve përcaktoi disa standarde etike dhe procedura disiplinore për rastet e shkeljeve. Gjithashtu, u hartua një rregullore për rekrutimin e punonjësve me qëllim rritjen e transparencës dhe drejtësisë në procedurat e rekrutimit. Këto instrumente u shoqëruan edhe me një program të brendshëm trajnimi, i cili ka për qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të burgjeve. Rëndësi e veçantë iu kushtua kujdesit për të burgosurat femra dhe të burgosurit e mitur.

MBËSHTETJE PËR FUTJEN E MJETEVE EFEKTIVE NË VEND PËR TË PARANDALUAR SHKELJET E KONVENTËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ky projekt filloi më 1 janar 2017 dhe do të vazhdojë deri më 23 maj 2019.

Projekti ka për qëllim të mbështesë autoritetet shqiptare në marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), duke i lejuar Shqipërisë të përparojë në zbatimin e reformave kryesore gjyqësore.

- U vlerësua skema ekzistuese e kompensimit dhe kthimit të pronave të shpronësuara gjatë regjimit komunist dhe u identifikuan hapat e mëtejshme për përmirësimin e efikasitetit të saj për të garantuar një kompensim të kënaqshëm. Në vijim të këtij vlerësimi, projekti, në kuadrin e këtij instrumenti, realizoi një sërë aktiviteteve konkrete në mbështetje të përpjekjeve të autoriteteve vendase për zbatimin e mekanizmit të kthimit/kompensimit të pronave në Shqipëri. Një rezultat përbëri miratimi nga ana e [Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të një rezolute](#) më 20 shtator 2018, përmes së cilës u mbyll shqyrtimi i grupit të çështjeve *Manushaqe Puto e të tjerë*, duke qenë se vlerësoi se janë marrë masat e kërkuara për ofrimin e kompensimit të pronës dhe për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe administrative të formës së prerë në vend që njohin të drejtën e kompensimit.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



- Duke adresuar rekomandimet e Komitetit të Ministrave në lidhje me grupin e çështjeve *Caka*, projekti ofroi një analizë të mënyrave të zbatimit efektiv të akteve të legjislacionit të brendshëm penal për rihapjen e procedimeve gjyqësore në vijim të vendimit të GjEDNj-së. Ky projekt përfshiu ofrimin e asistencës në identifikimin e përmirësimeve të mëtejshme të nevojshme dhe këshillave për harmonizimin e praktikës vendase, në mënyrë që çdo qytetar i prekur nga vendimet e brendshme, të anuluar nga GjEDNj-ja, të përfitojë nga rigjykimi i çështjes së tij, bazuar në jurisprudencën e GjEDNj-së.
- Në bazë të një analize të legjislacionit dhe praktikës, u identifikuan arsyet e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore. Bashkë me institucionet përfituese, u përcaktuan hapat e mëtejshëm për përmirësimin e menaxhimit të kohës gjyqësore. Kjo do të lehtësojë mbikëqyrjen nga Komiteti i Ministrave të ekzekutimit të grupit të çështjeve *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*. Projekti po monitoron aktualisht zbatimin e ndryshimeve të reja legjislative me qëllim mbështetjen e procedurave efikase dhe të shpejta gjyqësore.
- U ndryshua Ligji për Avokaturën e Shtetit më 22 nëntor 2018, duke përforcuar kapacitetin e brendshëm për ekzekutimi efikas të vendimeve të gjykatave, duke e sjellë kështu legjislacionin shqiptar më afër standardeve më të mira evropiane.
- Me qëllim zbatimin e legjislacionit për kthimin/kompensimin e pronës, procedura të arsyeshme gjyqësore dhe rihapjen e çështjeve pas shkeljes së një vendimi të GjEDNj-së, u forcuan kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës dhe të Shkollës së Avokatisë. Për të ofruar trajnime cilësore për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, u hartuan manuale të hollësishme trajnimi për mjetet juridike efektive për procedurat e tejzgjatura, të drejtat e pronësisë, si dhe për drejtësinë e procedurave penale, të cilat u integruan në programin e brendshëm të trajnimit. Deri tani, janë kualifikuar dhe pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme 36 trajnerë vendas, të cilët do të zhvillojnë seancat e trajnimit pas përfundimit të këtij projekti. Mbi 200 përfaqësues të gjyqësorit dhe profesionistë të tjerë të fushës së drejtësisë u pajisën me këto manuale dhe u trajnuan falë mbështetjes së projektit. Kjo do të rrisë shanset për një zbatim më të mirë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri.

FORCIMI I CILËSISË DHE EFIÇENCËS SË SHËRBIMEVE GJYQËSORE

Ky projekt filloi më 1 korrik 2016 dhe do të vazhdojë deri më 23 maj 2019.

Ky projekt kontribuon në zbatimin e aspekteve kyçe të procesit të reformave gjyqësore me qëllim forcimin e cilësisë dhe efiçencës së drejtësisë, duke përdorur mjetet dhe metodologjinë e Komisionit Evropian për Efiçencën e Drejtësisë (CEPEJ). Ky projekt ka arritur këto rezultate:

- Hartimin e një metodologjie për rishikimin e hartës gjyqësore – shpërndarjen e organeve gjyqësore në vend – për t'iu përgjigjur nevojave të reja me qëllim dhënien e drejtësisë. Kjo

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



metodologji u hartua me qëllim marrjen e masave konkrete për rishikimin e hartës gjyqësore të Shqipërisë, me qëllim forcimin e aksesit në drejtësi, duke garantuar në të njëjtën kohë cilësinë e saj.

- Ky projekt ndihmoi në përmirësimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve: janë mbyllur një numër i konsiderueshëm çështjesh të vjetra në Gjykatën e Rrethit të Lezhës dhe në Gjykatën e Apelit. Janë trajnuar punonjës gjykatash në këtë fushë, duke përmirësuar kështu menaxhimin e gjykatave.
- Kontribuoi në futjen në përdorim të një sistemi të ri elektronik të menaxhimit të çështjeve në bashkëpunim të ngushtë me EURALIUS¹ dhe USAID. Projekti mbështet autoritetet në hartimin e një strategjie të re për futjen e disa ndryshimeve, të cilat përfshijnë përdorimin më të madh të drejtësisë elektronike të përshtatur sipas specifikave shqiptare. Kjo strategji ofron mënyra për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave gjyqësore me qëllim adresimin e shkaqeve që qëndrojnë pas numrit të prapambetur të çështjeve dhe tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, të cilat do të përdoren në ngritjen e sistemit të ardhshëm elektronik të menaxhimit të çështjeve.
- Përmirësim të kapaciteteve të Gjykatës Administrative të Apelit në Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Shkodër për kryerjen e sondazheve të kënaqësisë së përdoruesve të gjykatave dhe për adresimin e gjetjeve përkatëse. Dy gjykatat e përzgjedhura filluan të marrin masa për adresimin e shqetësimeve të ngritura nga përdoruesit në sondazhet e kënaqësisë.
- Forcimin e sigurisë në gjykata, kryesisht përmes vlerësimit të risqeve ekzistuese dhe masave për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave. Autoritetet shqiptare kanë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e rekomandimeve të dala nga ky vlerësim.
- Përmirësimin e marrëdhënieve mes gjyqësorit dhe medias. Përfaqësuesit e gjykatave, prokurorive dhe medias u trajnuan në hartimin e njoftimeve për shtyp dhe për përmirësimin e faqeve të tyre të internetit dhe komunikimit në lidhje me çështje tejet delikate. Trajnimi u ofroi udhëzime dhe masa konkrete për rritjen e besimit të publikut tek gjyqësori përmes një komunikimi më të mirë.
- Hartimin e moduleve për menaxhimin e gjykatës për programet fillestare dhe të vazhduara të trajnimit që ofron Shkolla e Magjistraturës. Këto module janë integruar në programin e trajnimit të Shkollës dhe përbëjnë një instrument të përhershëm të trajnimit të gjyqësorit për përmirësimin e metodave të tij të punës. U vazhdua me trajnimin e punonjësve të gjykatave, duke hapur kështu mundësi për një drejtësi më efiçente dhe më të drejtë.

¹ "Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri" (**EURALIUS**) është një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian që konsiston në ofrimin e asistencës teknike në përpjekje për të forcuar Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented
by the Council of Europe

LUFTA KUNDËR KRIMIT EKONOMIK

Ky projekt ka filluar më 24 maj 2016 dhe do të vazhdojë deri më 23 maj 2019.

Korrupsioni dhe pastrimi i parave cenojnë besimin tek institucionet shtetërore. Kjo masë ka për qëllim të mbështesë autoritetet në marrjen e masave për parandalimin dhe hetimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave, duke zbatuar rekomandimet e dhëna nga Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL).

- Progres është arritur në forcimin e legjislacionit për financimin e partive politike për të luftuar më mirë praktikën korruptive. Ligji për financimin e partive politike dhe Kodi Penal u ndryshuan, duke marrë parasysh rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe dispozitat e reja u zbatuan në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017. Në vijim të mbështetjes për përmirësimin e legjislacionit, Kryeministri nxori Urdhrin për ndalimin e përdorimit nga partitë politike të burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore për qëllimet e tyre elektorale. Si rrjedhojë e të gjitha këtyre masave, kostot e fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare u ulën, duke adresuar në këtë mënyrë një prej mangësive kryesore të procesit zgjedhor të Shqipërisë - shpenzimet e tepruara për fushata zgjedhore.
- Hapa janë ndërmarrë edhe për forcimin e procesit të rikuperimit të aseteve, gjatë ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave të krimit të lidhura me korrupsionin, duke forcuar në mënyrë të veçantë kuadrin ligjor dhe strategjik për menaxhimin dhe rikuperimin e aseteve, si dhe duke ngritur një Zyrë multidisiplinare të Rikuperimit të Aseteve.
- Për të përforcuar sistemin ekzistues të deklarimit të pasurive, ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, miratuar në prill të vitit 2017, u përmirësua më tej në dhjetor të vitit 2018, duke pasqyruar rekomandimet e Këshillit të Evropës. Ky projekt ka mbështetur gjithashtu Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) në ngritjen e një sistemi elektronik për dorëzimin, përpunimin dhe publikimin e deklarimeve të pasurive. U forcuan kapacitetet e inspektorëve për zbatimin e kërkesave të reja ligjore për dorëzimin dhe verifikimin e deklarimeve të pasurive.
- Kapacitetet e agjencive të zbatimit të ligjit për të luftuar pastrimin e parave dhe korrupsionin u përmirësuan më tej përmes udhëzimeve praktike, seminareve dhe trajnimeve për gjurmimin dhe konfiskimin e aseteve. Në Shqipëri, 253 persona ishin objekt i procedimeve ligjore, gjë që çoi në kapjen e afërsisht 16 milionë Eurove dhe konfiskimin e 1.5 milion Eurove në periudhën maj 2017 - maj 2018.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



- Mbështetja për aktivitetet parlamentare ishte në qendër të punës së këtij projekti, me qëllim luftën ndaj praktikave korruptive nga deputetët. Komisioni Parlamentar për Imunitetet miratoi një Kod Sjelljeje për Anëtarët e Parlamentit, duke ndërmarrë kështu një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së rekomandimeve të GRECO-s. Kodi i Sjelljes përcakton standardet e sjelljes etike dhe parashikon sanksione për shkeljen e tyre, duke forcuar në këtë mënyrë detyrimet etike të parlamentarëve.
- U forcuan kapacitetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me mbikëqyrjen e financimit të fushatave zgjedhore dhe partive politike. Për këtë qëllim u ngrit një njësi e veçantë mbikëqyrjeje. U miratuan disa rregulla për përdorimin e materialeve të fushatave, siç ishin udhëzimet për mënyrën e monitorimit të fushatave zgjedhore dhe llogaritjes së kostove të tyre. Kjo gjë qartësoi kërkesat ligjore dhe rregullatore, duke ofruar në të njëjtën kohë edhe këshilla praktike. U hartuan instrumente të reja, si p.sh. formatet e standartizuara për raportim mbi financimin e fushatave. Së bashku me ekspertët e sapoemëruar financiarë për monitorimin e fushatave në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e mësipërme, këto instrumente u futën në përdorim për monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2017. Si rrjedhojë e kësaj mbështetjeje, shtatë parti politike u gjobitën për shkelje të rregullave të financimit të partive politike gjatë zgjedhjeve të vitit 2017.

LUFTA KUNDËR BULLIZMIT DHE EKSTREMIZMIT NË SISTEMIN ARSIMOR

Ky projekt filloi më 1 qershor 2016 dhe do të vazhdojë deri më 31 janar 2019.

Duke përdorur përvojën e shkollave pilot, projekti ka për qëllim mbështetjen e autoriteteve kombëtare në hartimin e strategjive dhe masave kundër bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla, duke rritur në të njëjtën kohë ndërgjegjësimin e të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollave - fëmijëve dhe të rinjve, prindërve dhe stafit arsimor - rreth dëmit që shkakton bullizmi dhe mënyrave se si mund të mbrohen fëmijët dhe të rinjtë.

- Ligji i ri për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar në shkurt 2017, njeh fenomenin e bullizmit në shkolla dhe përfshin parashikimin e ngritjes së mekanizmave për të garantuar parandalimin dhe raportimin e tij efektiv. Objektivat e projektit u integruan edhe në "Programin Kombëtar për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020".
- 21 nëntori është shpallur Dita Kombëtare kundër Bullizmit në Shkolla në Shqipëri.

Anëtarë të komuniteteve lokale dhe media, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, prindërit dhe stafin shkollor, mund të kuptojnë tani më mirë dëmin që shkakton bullizmi dhe mënyrat se si mund të mbrohen fëmijët dhe të rinjtë. Projekti mbërriti tek afërsisht 14 000 qytetarë përmes Ditës Kombëtare kundër Bullizmit, transmetimeve radio-televizive dhe ditëve të hapura kundër bullizmit në shkolla.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave nxorën një vendim të përbashkët, duke i instruktuar zyrtarisht shkollat pilot për zbatimin e planeve të veprimit kundër bullizmit gjatë vitit shkollor 2018/2019; koordinimin e aktiviteteve ndërgjegjëse ndërmje shkollave; marrjen e masave për organizimin e ditës kundër bullizmit më 21 nëntor; ndërmarrjen e hapave për të shkëmbyer njohuri me shkolla të tjera; si dhe për monitorimin dhe përmirësimin e sistemeve të referimit në lidhje me çështjet e bullizmit në shkolla.
- Në bazë të njohurive dhe praktikave të mira të shkollave pilot, u propozua një udhërrëfyes kombëtar për orientimin e politikëbërësve në parandalimin dhe uljen e bullizmit, si dhe për krijimin e një mjedisi shkollor të sigurt dhe gjithëpërfshirës në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për t'u integruar më tej në Strategjinë e Re Kombëtare për Arsimin Parauniversitar.
- Një program për trajnimin e mësuesve dhe mbështetjen e shkollave - i konceptuar si një program ndërhyrjesh hap-pas-hapi për mësuesit me qëllim parandalimin ose reduktimin e bullizmit, krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe hartimin e politikave dhe procedurave - u akreditua nga Komisioni për Akreditimin e Moduleve dhe Programeve të Trajnimit për periudhën 2017-2021.
- 210 mësues, anëtarë të ekipeve shkollore kundër bullizmit nga 21 shkollat pilot, u trajnuan si agentë ndryshimi në parandalimin ose uljen e bullizmit në shkolla.

PARANDALIMI DHE LUFTA NDAJ DISKRIMINIMIT ME BAZË ORIENTIMIN SEKSUAL DHE IDENTITETIN GJINOR

Ky projekt u zbatua nga 1 tetori 2016 deri më 31 maji 2018.

Ky projekt pati si qëllim mbështetjen e autoriteteve kombëtare në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në lidhje me çështjet e LGBTI-ve në Shqipëri.

- U ngrit një ekip ndërministror përgjegjës për monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2016-2020 për personat LGBTI në Shqipëri, i cili është tashmë funksional.
- Mbi 150 punonjës policie nga vende të ndryshme të Shqipërisë (Tirana, Durrësi, Kukësi, Lezha, Korça, Vlora dhe qytete të tjera) u trajnuan për identifikimin dhe adresimin e krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTI.

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey



- U hartua një udhëzues për "Policimin e krimeve të urrejtjes kundër personave LGBTI: Trajnim për një reagim profesional të policisë", i cili është integruar në programin e Akademisë së Sigurisë për trajnimin e vazhduar të policisë.
- U forcuan kapacitetet e 45 pikave fokale gjinore, të vendosur pranë bashkive në Shqipërisë, në lidhje me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për LGBTI-të. Është akredituar një program trajnimi nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), si dhe një modul trajnimi online për të drejtat e personave LGBTI gjendet tashmë në internet dhe mund të vizitohet përmes faqes zyrtare të ASPA-s.

FORCIMI I MBROJTJES SË PERSONAVE QË U PËRKASIN PAKICAVE KOMBËTARE

Ky projekt filloi më 1 janar 2017 dhe do të vazhdojë deri më 23 maj 2019.

Projekti ka për qëllim forcimin e mbrojtjes së personave që u përkasin pakicave kombëtare në Shqipëri, duke adresuar kuadrin ligjor dhe politikat, si dhe kapacitetet institucionale të autoriteteve, duke pasur parasysh rekomandimet e bëra nga Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMP) dhe Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.

- Në tetor 2017 u miratua një ligj kuadër gjithëpërfshirës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, i cili heq diferencimin mes pakicave kombëtare dhe komuniteteve etno-gjuhësore, si dhe njeh nëntë pakica kombëtare dhe parimin e vetë-identifikimit.
- U siguruan dy opinione ligjore në lidhje me aktet nënligjore, të cilat iu dorëzuan qeverisë.

PËR MË SHUMË INFORMACION:

Faqja e internetit: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>

Nichola Howson, Këshilltare për Komunikimin, +33 3 88 41 22 39

Marija Simic, Këshilltare Rajonale për Komunikimin, +38 1 63 60 13 37